

Liberalizmi akademik

## **Description**





## Atë Raymond Brown

Fragment i shkëputur nga libri i Atë Raymon Brown me titull: "An Introduction to New Testament Christology", Paulist Pres, New York 1994

Kjo qasje dallon nga ajo e liberalizmit jo akademik në shumë mënyra. Ajo pranon se Dhjata e Re është e mbushur me pasazhe kristologjike nga fillimideri në fund dhe mbështetësit e kësaj qasje besojnë se Jezusi ka qenë më shumë se thjesht një mësues etike apo reformator social. Megjithatë, siç nënkuptohet edhe nga termi "liberalizëm", ajo nuk pranon se vlerësimet ekristologjike të lartë (high christology) për Jezusin, që gjenden në Dhjatën e Re, janë në vazhdimësi vlerësimin e tij për veten. Shkurt, vlerësimet e kristologjike të lartë për Jezusin janë parë si të gabuara<sup>1</sup>. Për të mbrojtur këtë mendim, teologët e liberalizmit akademik kanë gjurmuar procesin "krijues" në kristologjinë e Dhjatës së Re, me një metodologji shumë të kujdesshme. Prej tyre kemi marrë skemat e para të detajuara të zhvillimit të mendimit në Dhjatën e Re. Ata theksonin mundësinë për të gjurmuar zhvillimin e këndvështrimeve të ndryshme teologjike që nga bashkësia hebre-folëse<sup>2</sup> në Palestinën e judeo-krishterimit (jewish christian), tek ajo e të judeo-krishterëve (jewish christian) greqisht-folës në Siri, për tek bashkësitë greqisht-folëse të krishterëve xhentil (Gentil Christian) në Azinë e Vogël dhe Greqi, së fundmi tek bashkësitë e ndikuara nga gjenialitete individuale si ato të Palit dhe Gjonit. Që nga fundi i shekullit të 19 e.s. shkollarët mendonin se zotëronin të dhënat emjaftueshme historike dhe gjuhësore për të përcaktuar me saktësi të mjaftueshme si fazat individuale të zhvillimit të mendimit të krishterë ashtu edhe ato të terminologjisë së përdorur në çdo fazë për të përshkruar Jezusin.<sup>3</sup>

Për më tepër, ajo ishte koha e entuziazmit të madh për disiplinën e krahasimit të feve. Interpretuesit e Dhjatës së Re, me qasje liberale pohonin semund të gjenin në mitologjinë religjioze të Greqisë dhe Romës terminologjinë kyç dhe simbolikën e aplikuar për Jezusin, si psh. në mitin e vjetër të Zeusit që ishte martuar me një grua dhe kishte lindur një djalë hyjnor mund të gjendej shpjegimi i paraqitjes së Jezusit si biri i Perëndisë i konceptuar pa një baba njerëzor; apo në mitin e vdekjes dhe ringjalljes të bimësisë, shpjegimin për tezën e ringjalljes së Jezusit nga të vdekurit. Në pohim izakonshëm i bërë në qarqet liberale në lidhje me zhvillimin e kristologjisë ka qenë ai sipas së cilit titujt si Zot (Lord) dhe Biri i Perëndisë i janë veshur Jezusit në kuptimin hyjnor vetëm në misionin e krishterë drejtuar xhentilëve greqisht-folës. Sipas tyre këto emërtime, ose nuk kishin ekzistuar në fazën e hershme të judeo-krishterimit (Jewish Christianity), ose kanë qenë të pranishëm, por kanë qenë përdorur në një kuptim më modest, në kuptimin e zotërisë dhe Mesias (mbretit të vajosur)<sup>4</sup>. Ky spekulim të jipte idenë e një zhvillimi linear drejt një "kristologjie të lartë", d.m.th. drejt një kristologjie që gradualisht gjithnjë e më shumë kishte përdorur titujt për Jezusin që të kujtonin hyjnorin. Ky zhvillim linear kishte lëvizur ngabota hebraike në atë helene, duke nisur nga shekulli i parë drejt periudhave të mëvonshme. Shpikja e kristologjisë së lartë shpesh është trajtuar si një *felix culpa*, për arsye se mendohej se vetëm përmes këtij hyjnizimi mund të ruheshin kujtimet e Jezusit. Jezusi historik ishte, në fakt, një predikues me kërkesa të forta morale që sfidoi institucionet religjioze dhe idetë e gënjeshtërtat të kohës së tij. Ideat dhe idetë mendjemprehta të tij nuk humbën për arsye se bashkësia i veshi kujtimin të tij një kristologji që e shndërroi atë në Birin e njeriut hyjnor, Zotëri (Lord) dhe gjykatës të botës, pra në një Perëndi. Pa këtë zmadhim ai dhe mesazhi i tij do të ishin harruar. Ndonëse në shekujt e parë kjo lloj kristologjie ishte e nevojshme për të mbajtur gjallë kujtimin e tij, në gjykimin e shumicës së shkollarëve liberal në ditët tona ajo nuk është më e nevojshme. Sipërmarrja e sotme akademike, pohohej, mund ta përcaktojë me siguri Jezusin historik dhe të mbështetet në të pa ndjerë nevojën për zbulimet dhe stërzmadhimet e kristologjisë. Shkolla të ndryshme të liberalizmit janë shfaqur gjatë shekullit të 20: si psh., në fillim të viteve 1990 e.r.s. shkruanet e J.D. Crossan dhe B. Mack (shih faqe 216 më poshtë), të cilët përdorën ungjijtë apokrif apo burimin Q për të argumentuar se paraqitjet kristologjike të ungjijve kanonik janë gjerësisht fiktive.

---

[\*] Atë Raymond Brown është Distinguished Professor Emeritus of Biblical Studies në Union Theological Seminary (N.Y.C.). Ai konsiderohet si një prej figurave qendrore ndërmjet shkollarëve të Dhjatës së Re. Gjatë jetës së tij ka marrë mëse tridhjetë "honorary degrees" nga universitetet katolike

**Date Created**

15/10/2014

**Author**

erasmusi